



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Komisioni Komunal për Vlerësimin dhe Dhënien në shfrytëzim të Pronës
së Paluajtshme Komunale
Nr. 02/16
Dt. 18.10.2016

Në bazë të nenit 108 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28, për shkak se Autoriteti Kontraktues ka pranuar Kërkesë për rishqyrtim të vendimit për Njoftimin për Dhënie të Kontratës në aktivitetin e Ankandit: “ Dhënia në shfrytëzim me qira e pronës së paluajtshme komunale “ të dt. 01.09.2016, **Komisioni Komunal për Vlerësimin dhe Dhënien në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale** më dt. 18.10.2016, nxjerr këtë :

K O N K L U Z I O N
Për Korrigjimin e Vendimit për dhënie të kontratës

- I. **KORRIGJOHET** njoftimi për Dhënie të Kontratës Nr. 01-007-52177 i dt. 11.10.2016 në pikën IV.4. paragrafi 1 ashtu që Mexhid Duraku –t i jepet në shfrytëzim me qira, parcela nr. 087-0, Zona Kadastrale Stanofc i Poshtëm, në sipërfaqe prej 02.07.50ha, me çmimin :
Çmimi i qirasë për 1 ha = 150,00€
Çmimi vjetorë i qirasë = 311,25€.
- II. Ky Konkluzion hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.
- III. Kundër këtij Konkluzioni nuk është e lejuar ankesë e veçantë.

A r s y e t i m

Komuna e Vushtrrisë, përkatësisht **Komisioni Komunal për Vlerësimin dhe Dhënien në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale**, në bazë të vlerësimit të ofertave të pranuar sipas Ankandit publik të dt. 01.09.2016, z. Mexhid Duraku e ka shpallur fitues të ankandit për dhënien në shfrytëzim me qira të pronës së paluajtshme komunale, në parcelën nr. 087-0, Zona Kadastrale Stanofc i Poshtëm, në sipërfaqe prej 02.07.50ha, me çmimin: 150,00€/1ha apo 405,00€/për tërë sipërfaqen.

Në bazë të vërejtjes në çmimin e qirasë të paraqitur nga z. Mexhid Duraku, **Komisioni Komunal**, duke rishikuar saktësinë e llogaritjes së çmimit të qirasë sipas vendimit Nr. 01-007-52177 i dt. 11.10.2016, ka konstatuar se gabimi në llogaritje të çmimit të qirasë është i dukshëm dhe real, andaj ka vendosur për Korrigjimin e çmimit të qirasë vjetore për z. Mexhid Duraku, ashtu sikurse është saktësuar në pikën I të këtij Konkluzioni.

Bazuar në Kërkesën e të përmendurit, mbështetur në nenin 108 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 02/L-28, citat : “ *Gabimet materiale në shprehje të vullnetit të organit administrativ, kur këto janë të dukshme, mundë t korrigjohen në çdo kohë nga organet që kanë të drejtë të bëjnë revokimin/shfuqizimin e aktit* “ **Komisioni Komunal për Vlerësimin dhe Dhënien në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale** ka vendosur si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

**Komisioni Vlerësues për Dhënien në
Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme
Komunale**

K r y e t a r i,

Hyda Dallku